

Manuali i Përdorimit të Exam.net për Studentët e Albanian University

Tek manuali më poshtë do te gjeni mënyrën se si do të mund të zhvilloni një provim ose modul online.

Exam.net është faqe e cila mundëson zhvillimin e provimeve online.

Hapi 1: Duhet të siguroheni që keni marrë kodin e provimit nga lektori/pedagogu juaj për lëndën përkatëse.

p.sh: iCzZPL

Sigurohuni që ta keni marrë kodin pa filluar provimi

Hapi 2: Shkoni tek faqe exam.net

Tek hapësira Enter exam key vendosni kodin e marrë për provimin si shfaqur më poshtë:

Klikoni **Next**

Hapi 3: Dritare që shfaqet kërkon nga ju informacionet si më poshtë:

Student

Teacher

 Student

✓ CHANGE

FETCH THE EXAM

Please enter some information about yourself. To read more about why we need your personal data, click [here](#).


- Name duhet të plotësohet me Emrin tuaj p.sh John;
- Last Name duhet të plotësohet me mbiemrin tuaj p.sh Doe;
- Class duhet të plotësohet me lëndën në degën që do të kryeni provimin;
- Teachers name duhet të plotësohet me emrin e lektorit të lëndës për të cilën do të kryeni provimin;
- Phone Number duhet të plotësohet me numrin tuaj të telefonit.

Të dhënat që ju duhet të plotësoni janë përcaktuar nga pedagogu juaj, pra mund të mos ju kërkojnë të gjithë të dhënat e listuara më sipër.


Klikoni **FETCH THE EXAM** për të hyrë në provim.

Hapi4: Faqe që shfaqet ju tregon që provimi është gati të fillojë:

Klikoni **Begin exam**




Hapi5: Faqe që hapet tregon nisjen e provimit.



1 – Sigurohuni që të shihni emrin tuaj;


2 – Hapësira e shfaqjes së tezës e cila mund të bëhet scroll down me rrotën e mousit ose me prekje (në rast celulari ose tableti);

- 3 – Hapësira juaj e shkrimit – Ketu do t'u përgjigjeni pyetjeve të tezës së mësipërme;
- 4 – Tregohet ora , bateria e celularit ose laptopit dhe koha e mbetur nga përfundimi i provimit.
- 5 – Hapet një dritare e një chati, ku edhe mund ti bëni pyetje lektorit tuaj në lidhje me tezën.




Hapi 6: MOS KOPJONI

- Nëse dilni nga faqe e provimit;
- Nëse minimizoni faqen e provimit;
- Nëse klikoni diku tjetër që nuk është faqe e provimit;
- Nëse tentoni të kopjoni;
- Në ekran do ju shfaqet një mesazh që lexon **Locked Out**




Ky mesazh I shkon edhe lektorit përkatës me emrin tuaj. Për të vazhduar provimin duhet të shpjegoni arsyen përse keni dalë nga faqe e provimit.




Klikoni tek **Request Unlock** i cili do të njoftojë lektorin tuaj dhe më pas ai vendos nëse do ju hapet provimi përsëri.

Hapi 7: Pasi të plotësoni tezën klikoni tek **Submit exam**



Konfirmojeni tek tabela qe shfaqet:



Suksese!